

K O N T R A T E

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ANONIME PËR EFEKTE

PUBLIKE "ALFA"

Në Tiranë sot më 20 Gusht 1993 të nënshkruarit:

1. Vasil Naçi, i Spiros lindur më 1967 në Vrisera të Gjirokastrës banues po në Vrisera shtetas shqiptar.

2. Kostas Sotiris, i lindur më 1960 në Vrisera të Gjirokastrës, banues po në Vrisera, shtetas shqiptar.

3. Kristo Naçi i Spiros lindur më 1970 në Vrisera të Gjirokastrës, banues po në Vrisera; shtetas shqiptar.

4. Jorgo Zaidhis i Panajotit, lindur më 1967 në Janinë të Greqisë dhe banues në Janinë, shtetas grek.

Arritën marrëveshjen për krijimin e Shoqërisë Anonime për efekte Publike në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë në kushtet që vijojnë:

Neni 1 Emërtimi dhe qendra

1. Emërtimi i Shoqërisë


"ALFA" SHA

2. Qendra e Shoqërisë

Vrisera - Rrethi Gjirokastrë

Neni 2 Qëllimet e Shoqërisë

2.1. Shoqëria mund të krijojë qendra shërbimi, dyqane e filiale në Territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me kërkesat e legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.





2.2. Shoqëria ka për objekt Import-Eksport të mallrave industriale e ushqimore, tregtimin e tyre me shumicë e pakicë; Transport mallrash dhe udhëtarësh; Krijimi i pikave të karburantit dhe shitjen e tij; Përgatitje, përpunim, ambalazhim e produkteve ushqimore.

Neni 3 Regjimi ekonomik

- 3.1. Shoqëria udhëhiqet në veprimtarinë e saj nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë veçanërisht nga ligji Nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare".
- 3.2. Shoqëria gëzon mbrojtje dhe sigurim të plotë si investitor i huaj në përputhje me ligjin "Për investimet e huaja".
- 3.3. Shoqëria gëzon afirmim ligjor që nga dita e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë.
- 3.4. Të drejtat dhe detyrat e Shoqërisë përcaktohen në kontratën dhe statusin e Shoqërisë.
- 3.5. Librat kontabile mbahen nga Shoqëria në përputhje me ligjet në fuqi në gjuhën shqipe dhe gjuhën greke.

Neni 4 Kapitali bazë (Kapitali themelor)

- 4.1. Kapitali bazë i shoqërisë është dy milion lekë.
- 4.2. Përqindjet e pjesëmarrjes së ortakëve në kapitalin bazë janë:
- 4.3.
- | | | |
|---------------|----|----------|
| Vasil Naçi | 25 | për qind |
| Kostas Sotiri | 25 | Për qind |
| Kristo Naçi | 25 | për qind |
| Jorgo Zoidhis | 25 | për qind |



4.4. Kapitali bazë formohet si vijon:

Vasil Naçi	500000	lekë
Kosta Sotiri	500000	lekë
Kristo Naçi	500000	lekë
Jorgo Zoidhis	500000	lekë

4.5. Kapitali bazë mund të shtohet nga kontributet plotësuese të ortakëve.

Çdo ndryshim në kapitalin bazë do të bëhet me kontributin ortakëve sipas përqindjes së tyre, me përjashtim të restit kur unanimisht është vendosur e kundërta. Shtimi i kapitalit bazë vendoset me shumicën e anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

Neni 5 Drejtimi i Shoqërisë

5.1. Drejtimi realizohet nga këto organe:

Asambleja e ortakëve

Këshilli Mbikqyrës

Drejtoria

5.2. Mënyra e emërimit dhe kompetencat e tyre përcaktohen dhe përshkruhen në statutin e Shoqërisë.

Neni 6 Sigurimi i Shoqërisë

6.1. Pasuria e Shoqërisë sigurohet në bazë të legjislacionit të Republikës të Shqipërisë.

6.2. Me vendim të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë mundet të ketë edhe sigurim plotësues të pasurisë.

Neni 7 Ndarja e fitimeve

- 7.1. Fitimi neto ndahet midis ortakëve sipas përqindjes së pjesëmarrjes së tyre.
- 7.2. Fitimi neto i ortakëve të huaj mund të eksportohet jashtë me valutë të huaj në përputhje me udhëzimet dhe ligjet për investimet e huaja në Republikën e Shqipërisë.
- 7.3. Ortakët e huaj mundet gjithashtu të eksportojnë lirisht lëndë të para, produkte dhe shërbime që janë përfituar nga fitimet e tyre neto në shoqëri në valutë vendase.
- 7.4. Me vendim të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë fitimi mund të investohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 8 Afati i veprimit të Shoqërisë

- 8.1. Afati i veprimit të Shoqërisë është 20 vjet që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.
- 8.2. Data e hyrjes në fuqi të kontratës së krijimit të shoqërisë është data e nënshkrimit të saj nga ortakët.
- 8.3. Afati i funksionimit të Shoqërisë është afati i veprimit të kontratës së krijimit që fillon nga regjistrimi i Shoqërisë në regjistrin kombëtar të organit kompetent.

Neni 9 Likujdimi i Shoqërisë

- 9.1. Rastet dhe procedura e likujdimit të Shoqërisë si dhe e mbarimit të afatit të kontratës së krijimit përcaktohen në statusin e Shoqërisë.
- 9.2. Kontrata e krijimit mund të zgjidhet me vendim unanim të shkruar të ortakut.
- 9.3. Në rastet e likujdimit përfundimtar të Shoqërisë në përputhje me ligjin dhe me statusin e Shoqërisë, atëherë punon së vepruari edhe kontrata e krijimit të Shoqërisë.



[Handwritten signatures and initials]

Neni 10 Dispozita të përgjithshme

- 10.1. Kjo kontratë e krijimit ka si aneks statutin e Shoqërisë që është pjesë përbërëse e saj.
- 10.2. Adresa ligjore e Shoqërisë është ALFA SHA
- 10.3. Adresa : Vrisera - Gjirokastër
Tel:
Fax:
- 10.4. Çdo ndryshim dhe shtesë në këtë kontratë të krijimit si dhe në statutin e saj duhet bërë vetëm me shkrim dhe të nënshkruhet nga vetë ortakët.
- 10.5. Kjo kontratë nënshkruhet në Tiranë më 20 Gusht 1993 dhe hartohet në katër kopje të barabarta.

O R T A K Ë T

VASIL NAÇI

KOSTA SOTIRI

KOSTA NAÇI

JORGO ZAIDHIS



S T A T U T

PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË ANONIME PËR EFEKTE

PUBLIKE "ALFA"



Në Tiranë, sot më 20 gusht 1993 të nënshkruarit:

1. Vasil Naçi i Spiros lindur më 1967 në Vrisera të Gjirokastrës banues po në Vrisera shtetas shqiptar.

2. Kostas Sotiris, i lindur më 1960 në Vrisera të Gjirokastrës, banues po në Vrisera, shtetas shqiptar.

3. Kristo Naçi i Spiros lindur më 1970 në Vrisera të Gjirokastrës, banues po në Vrisera, shtetas shqiptar.

4. Jorgo Zaidhis i Panajotit, lindur më 1967 në Janinë të Greqisë dhe banues në Janinë shtetas grek.

Vendosën bashkërisht të miratojnë këtë statut të shoqërisë anpnime:

K R E U I

Neni 1 Qëllimi i Shoqërisë

Qëllimi i Shoqërisë përshkruhet dhe përcaktohet në nenin 1 të kontratës.

Neni 2 Emërtimi dhe qendra e Shoqërisë

2.1. Emërtimi i Shoqërisë

- Në gjuhën shqipe : ALFA

- Në gjuhën greqishte

2.2. Qendra e Shoqërisë është Tiranë në Republikën e Shqipërisë

Neni 3

Regjimi juridik



- 3.1. Shoqëria është "Shoqëri Anonime" që udhëhiqet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë. Ligji "për investimet e huaja" dhe ligji "për shoqëritë tregtare".
- 3.2. Me vendim unanimit "ortakët" mund të ndryshojnë Regjimin Juridik të "Shoqërisë" në qoftë se në të ardhmen krijohet premisa më të favorshme për funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar. Në këtë rast "Ortakët" do ta përshtasin "Kontratën e Krijimit" dhe "Statutin" e "Shoqërisë" dhe bëjnë regjistrimin e tyre në regjistrin e Shoqërive tregtare nga organet kompetente shqiptare.
- 3.3. "Shoqëria" gëzon mbrojtje e sigurim të plotë të ligjit "Mbi Investimet e Huaja" dhe marrëveshjen e nënshkruar midis Qeverisë të Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe përkujdesjen reciproke të investimeve datë 01.08.1991. "Shoqëria" do të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe do të bëjë rregullimet përkatëse me qëllim që në qoftë se në të ardhmen legjislacioni shqiptar premtion premisa më të përshtatshme për funksionimin dhe krijimin e ndërmarrjeve me pjesëmarrjen e huaj t'i gëzojë këto premisa të favorshme.
- 3.4. "Shoqëria" gëzon Personalitet Juridik nga data e regjistrimit të saj në regjistrin e "Shoqërive Tregtare" nga organet kompetente të Shqipërisë dhe në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.
- 3.5. "Shoqëria" mund të marrë detyrime dhe të padisi e të paditet përpara gjyqeve dhe përpara Arbitrazhit Ndërkombëtar.
- 3.6. "Shoqëria" mund të ketë pasuri në përputhje me dispozitat e legjislacionit shqiptar. Pasuria mbrohet në bazë të dispozitave të ligjit "Mbi Investimet e Huaja" dhe të marrëveshjes së nënshkruar midis Qeverisë të Greqisë Demokratike dhe Republikës së Shqipërisë për nxitjen dhe përkujdesjen reciproke të investimeve datë 01.08.1991.
- 3.7. "Shoqëria" do të ketë vulë të cilën do ta caktojë me vendimin e vet Drejtoria e "Shoqërisë".

K R E U II

TË DREJTA DHE DETYRA

- Neni 4 Të drejtat e "Shoqërisë" dhe të "Ortakëve"
- 4.1. "Shoqëria" ka të drejtë të lidhi marrëveshje dhe të nënshkruajë kontrata në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.2. "Shoqëria" gëzon të drejtë të krijojë pasuri (materiale e mendore).
- 4.3. "Shoqëria" gëzon të drejtën që të bëjë importime dhe eksportime të nevojshme për realizimin e qëllimeve të saj pa asnjë pengesë. Gjithashtu ka të drejtën e importimit, pa asnjë obligim e taksim të mjeteve të nevojshme materiale për materializimin e qëllimeve investuese.
- 4.4. "Shoqëria" gëzon të drejtën e caktimit të çmimeve të produkteve të saj që do të disponojë për tregun e brendshëm e të jashtëm sipas rregullave të legjislacionit në fuqi.
- 4.5. "Shoqëria" gëzon të drejtën që të krijojë shoqëri filiale, sektore, aneksorë ose zyra përfaqësimi në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 4.6. "Shoqëria" ka të drejtë të krijojë ndërmarrje të reja në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin që është në fuqi sipas rastit.
- 4.7. "Shoqëria" ka të drejtë të marrë pjesë si "Ortak" në ndërmarrjet ekzistuese në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj në përputhje me legjislacionin që është në fuqi, sipas rastit.
- 4.8. "Shoqëria" ka të drejtën e administrimit ekskluziv të pasurisë në bazë të legjislacionit në fuqi. "Shoqëria" ka të drejtë të vënies në ipotekë të elementëve të saj pasurorë në bazë të legjislacionit në fuqi dhe në përputhje me kushtet dhe frymën e këtij Statuti.
- 4.9. "Ortakët" mbajnë përgjegjësi kashi "Shoqërisë" deri në nivelin e kontributit të tyre në Kapitalin baze.
- 4.10. Zyra e Përfaqësimit dhe degët e "Shoqërisë" përgjigjen për detyrimet e tyre dhe "Shoqëria" përgjigjet për Zyrat e Përfaqësimit dhe degët e saj. "Shoqëria" nuk mban përgjegjësi për ndërmarrjet filiale as edhe ato filiale nuk mbajnë përgjegjësi për



"Shoqërinë".

- 4.11. "Ortakët" mund të paraqesin pretendime ndaj "Shoqërisë" në rastin e shkrirjes së saj në përputhje me kushtet dhe frymën e këtij Statuti.
- 4.12. Personeli i huaj i "Shoqërisë" ka të drejtën e pagimit të tij në valutë të huaj dhe të eksportimit të saj jashtë.
- 4.13. "Ortaku i Huaj" ka të drejtë të eksportojë fitimet e tij jashtë në valutë të huaj.
- 4.14. "Ortaku i Huaj" gjithashtu ka të drejtë të eksportojë lirisht lëndë të para produkte lëndë të para produkte dhe shërbime që janë paguar në valutë vendase nga fitimet e tij që rezultojnë nga pjesëmarrja e tij në "Shoqërinë".
- 4.15. "Ortakët", me vendim të Asamblesë mund të riinvestojnë fitimet e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë. Riinvestimet gëzojnë të njëjtin trajtim sikurse dhe investimet kryesore.
- 4.16. "Shoqëria" ka të drejtë të sigurojë personelin e saj dhe të pasurisë së saj pa asnjë kufizim e dallim.
- 4.17. "Shoqëria" gëzon të drejtat dhe përjashtimet nga tatimet sipas legjislacionit në fuqi dhe marrëveshjeve eventuale ndërshtetërore midis Republikës së Greqisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 Detyrimet e përbashkëta të "Ortakëve"

5.1. Të dy "Ortakët" detyrohen të depozitojnë kontributin e tyre në Kapitalin Bazë, sikurse përcaktohet në kontratë.

5.2. Çdo "Ortak" nëpërmjet përfaqësuesve të vet në Asamble dhe në Drejtori detyrohen të sigurojnë plotësimin e drejtë, të plotë dhe në kohë të detyrimeve të vet ndaj "Shoqërisë" dhe "Ortakut" tjetër në bazë të Kontratës së Krijimit dhe këtij "Statuti".

Neni 6 Plotësimi i detyrimeve

6.1. Kur një "Ortak" nuk i përgjigjet drejtë dhe në mënyrë të plotë detyrimeve atëherë "ortaku" tjetër e fton me shkrim që t'i plotësojë këto detyrime brenda 10 (dhjetë) ditë pune.

6.2. Në qoftë se nuk pranon, atëherë "Ortakut" i prekur ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblim. Niveli i dëmshpërblimit do të jetë përkatësisht me dëmin që ka shkaktuar. Ekspertet kontabel mund të caktojnë saktësisht nivelin e dëmshpërblimit. "Ortakut" i prekur ruan të drejtën e tij që ta apelojë në Arbitrazh në bazë të dispozitave të nenit 10 të Kontratës Themeluese.

Neni 7 Ruajtja e sekretit

7.1. "Ortakët" detyrohen që të mos nxjerrin tek të tretët të dhëna dhe njoftime sekrete që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike të "Shoqërisë".

7.2. Drejtoria e i "Shoqërisë" përcakton llojin e të dhënave dhe informatave që konsiderohen sekrete.

K R E U III


STRUKTURA ADMINISTRATIVE E SHOQËRISË

Neni 8 Asambleja e Përgjithshme e "Ortakëve"

8.1. Asambleja e Përgjithshme e "Ortakëve" është Organi më i lartë i "Shoqërisë".

Përbëhet nga tre (3) anëtarë, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së ortakëve.

- 8.2. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, merren me shumicë.
- 8.3. Çdo përfaqësues i "Ortakëve" mund të votojë me tërësinë e votave të "Ortakut" që përfaqëson (përderisa ligjërisht përfaqëson, anëtarët e tjerë të të njëjtit ortak.
- 8.4. Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë:
- 8.4.1. Ndryshimi i Kontratës së Krijimit dhe të Statutit të "Shoqërisë" dhe të përqindjes së pjesëmarrjes së "Ortakëve".
- 8.4.2. Ndryshimi ose shtimi i qëllimeve të "Shoqërisë".
- 8.4.3. Miratimi i rezultateve vjetore të "Shoqërisë".
- 8.4.4. Krijimi dhe mbyllja e ndërmarrjeve simotra, degëve, përfaqësimit dhe zyrave të përfaqësimit.
- 8.4.5. Riorganizimi dhe shkrirja ose mbyllja e "Shoqërisë". Organizimi dhe materializimi i projekteve të tjera të veprimtarisë së saj.
- 8.4.6. Mundësia e riinvestimit të fitimeve të saj në territorin e Shoqërisë pasi të jetë parashtruar propozimi nga drejtoria.
- 8.4.7. Miratimi i Raportit Vjetor të punës së kryer nga Drejtoria e "Shoqërisë".
- 8.4.8. Administrimi ekonomik i elementeve pasurore të "Shoqërisë" pas parashtrimit përkatës a Drejtorisë.
- 8.4.9. Shitja apo blerja e elementëve pasurore të "Shoqërisë" si dhe lidhjen e Marrëveshjeve me të tretë pas parashtrimit të Drejtorisë me vleftë mbi 3000000 lekë ose me vleftën ekuivalente në dollarë të SHBA në bazë të kursit zyrtar të ditës kur bëhet ky veprim.
- 8.4.10. Miratimi i çdo lloj garancie (ipoteke, pengu) të ofruar nga "Shoqëria" në formën e së të drejtës së posedimit të pasurisë së "Shoqërisë" si dhe të garancive të tjera që kanë të bëjnë me borxhet e "Shoqërisë" në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 8.4.11. Emëron dhe shkarkon anëtarët e Këshillit Mbikqyrës, zëvendëson anëtarët e papërshtatqëm dhe përcakton shpërblimin e tyre.
- 8.4.12. Për marrjen e vendimeve për çka parashikojnë nenet 8.4.1., 8.4.2., kërkohet unanimitet. Për rastet e tjera vendos Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e votave.



Neni 9

Mbledhjet vjetore - Mbledhjet e jashtëzakonshme

- 9.1. "Shoqëria" organizon një herë në vit Asamblenë e Përgjithshme të "Ortakëve".
- 9.2. Mbledhja e Jashtëzakonshme e "Ortakëve" bëhet me nismën e Drejtorisë, Këshillit Mbikqyrës, ekspertëve kontabël, ose të Ortakëve.
- 9.3. Lajmërimi me shkrim për mbledhjen duhet të dërgohet "Ortakëve" një më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e mbledhjes, sipas lajmërimit me letër ose telex me numrin që përmban ky statut. Lajmërimi për mbledhjen e jashtëzakonshme duhet të përmbajë edhe çështjen që do të diskutohet.
- 9.4. Mbledhja e Jashtëzakonshme e ortakëve gëzon kompetencat e paragrafëve të nenit 8, në atë rast kur janë të pranishëm jo më pak se katër (3) nga përfaqësuesit ligjor.
- 9.5. Në mbledhjen e Përgjithshme vjetore të Ortakëve kryeson kryetari, i Asamblesë ose zëvendësi i tij. Kryetari dhe zëvendësi zgjidhen nga anëtarët e Asamblesë me shumicë votash.
- 9.6. Në qoftë se nuk sigurohet prania e shumicës (në bazë të nenit 9.4.) gjatë 30 minutave të Mbledhjes së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, atëherë anulohet për një afat të caktuar që caktohet nga drejtuesi i mbledhjes, por jo më vonë se 30 ditë. Në qoftë se edhe me thirrjen e re nuk sigurohet shumica atëherë Mbledhja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme ka të drejtë të bëhet dhe të vendosi me shumicën e anëtarëve të pranishëm ose të autorizuarve të tyre.


Neni 10

Këshilli Mbikqyrës e "Shoqërisë"

Administrimi "Shoqërisë" kontrollohet nga Këshilli Mbikqyrës që emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e "Ortakëve" (A.P.O.)


- 10.1. Asambleja e Ortakëve emëron Këshillin Mbikqyrës prej (5) anëtarësh.
- 10.2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës emërohen ose shkarkohen me vendim të "Asamblesë së Ortakëve" që përfaqësojnë. Emrat e tyre i jepen Kryetarit të Asamblesë, të paktën njëzetekatër (24) orë para mbledhjes.

- 10.3. Mënyra e zgjedhjes - Afati
- Këshilli Mbikqyrës zgjedh Kryetarin dhe nënkryetarin e Këshillit.
- 10.3.1. Çdo anëtar i Këshillit Mbikqyrës gëzon një votë. Vendimet merren me shumicë. Kryetari nuk gëzon votë të privilegjuar.
- 10.3.2. Anëtarët e Këshillit Mbikqyrës zgjidhen për një afat dy (2) vjeçar. Afati mund të rishikohet nga Asambleja e "Ortakëve" që i ka emëruar.
- 10.3.3. Këshilli Mbikqyrës bën mbledhjet e zakonshme kur kjo gjykohet e nevojshme por jo më pak se katër (4) herë në vit. Këshilli Mbikqyrës thirret në mbledhje nga Kryetari i tij ose Nënkryetari me ftesë të shkruar, me telex ose telegram ku përfshihet edhe rendi i ditës.
- Ftesa duhet dërguar dy (2) javë para mbledhjes (duke përjashtuar ditën e dërgimit të ftesës dhe ditën e zhvillimit të Mbledhjes).
- 10.3.4. Shumica e domosdoshme (quorumi) për marrjen e vendimeve nga Këshilli Mbikqyrës konsiderohet prania e tre (3) Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës (duke përfshirë përfaqësuesit e ligjshëm të tyre) për thirrjen e parë të mbledhjes, ndërsa në mbledhjet përsëritëse konsiderohet shumica numri i pranishëm. Për marrjen e vendimeve të Këshillit Mbikqyrës mjafton shumica e thjeshtë.
- 10.3.5. Mbledhjet zhvillohen ose në qendrën e "Ortakëve" ose në qendrën e njërit prej "Ortakëve" ose në një vend tjetër që caktohet nga Këshilli Mbikqyrës. Mbledhja e Jashtëzakonshme mund të thirret nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës, nga çdo "Ortak" ose nga Drejtori i Përgjithshëm.
- 10.4. Në përputhje me ligjet në fuqi të Shqipërisë, nuk lejohet që në të njëjtën kohë anëtarët e Këshillit Mbikqyrës të jenë edhe anëtarë të Drejtorisë. Në rast të kundërt, anëtari i Këshillit Mbikqyrës që është edhe anëtar i Drejtorisë automatikisht humbet të drejtën e të qenurit anëtar i Këshillit Mbikqyrës.



Neni 11 Kompetencat e Këshillit Mbikqyrës

- 11.1. Këshilli Mbikqyrës mund të marrë vendime edhe me anën e korespondencës me telex ose me telegram në qoftë se asnjëri nga anëtarët e Këshillit Mbikqyrës nuk ka kundërshtim për këtë procedurë.
- 11.2. Ruhen protokollet e mbledhjes së Këshillit Mbikqyrës si dhe vendimet që janë marrë jashtë mbledhjeve (d.m.th. me korespondencë). Dosjet nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit Mbikqyrës ose zëvendësi i tij.
- 11.3. Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Mbikqyrës përcakton kapitalet e "Shoqërisë" si dhe vleftat e tyre përkatëse. Këshilli Mbikqyrës mund të shtojë ose pakësojë shumat e këtyre kapitaleve.
- 11.4. Me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Mbikqyrës miraton rrogat e personelit si dhe numrin e personelit.
- 11.5. Këshilli Mbikqyrës afron për shitje ose bën blerje elemente pasurore ose lidh kontrata për blerje apo shitje të elementeve pasurore ose çdo marrëveshje me të tretët nga shuma prej 1500000 lekë deri 3000000 lekë në vit ose në barazvlerë në dollarë të SHBA në bazë të kursit zyrtar, ditën që kryhet veprimi.
- 11.6. Këshilli Mbikqyrës është kompetent që të parashtrojë në Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve këto çështje:
- 11.6.1. Ndryshime ose shtesa në kontratën e krijimit dhe në "Statutin" e "Shoqërisë".
- 11.6.2. Miratimin e buxhetit vjetor të shpenzimeve rrjedhëse, miratimin e raportit vjetor të Administratës si dhe të raporteve të tjera ekonomike që parashikon ligji, ndarjen e pjesëve të fitimit, ose llogaritjen e saktë të humbjeve brenda afatit gjashtë (6) mujor që nga mbarimi i viti ekonomik.
- 11.6.3. Lidhjen e marrëveshjeve me të tretët (për import-eksport), dhënien e garancive dhe lidhjen e marrëveshjeve për akordim huaje në lekë ose në valutë, ipotekimin nga shuma prej 500000 lekë deri në shumën 2000000 lekë në vit ose në kundërvleftë në dollarë të SHBA, në bazë të kursit zyrtar ditën kur kryhet veprimi





- 11.6.4. Emërimin dhe shkarkimin nga detyra, caktimin e shpërblimit dhe vlerësimit e aktivitetit vjetor të Drejtorit të Përgjithshëm dhe të zëvendësimit të tij (Drejtorisë).
- 11.6.5. Zgjerimin e synimeve dhe të fushave të veprimtarisë së "Shoqërisë".
- 11.6.6. Përcaktimin e përmasave dhe karakterin e informacionit të besuar.

Neni 12 Drejtoria -Drejtori i Përgjithshëm

12.1. Drejtoria përbëhet nga dy(2) anëtarë:

- a) Drejtori i Përgjithshëm
- b) Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm

Drejtorja është organi ekzekutiv i "Shoqërisë". Drejtori i Përgjithshëm përfaqëson "Shoqërinë" tek të tretët, në përputhje me kontratën e krijimit dhe të "Statutit" si dhe vendimet e A.P.O.

12.2. Drejtori i Përgjithshëm dhe Zëvendësi emërohen për një afat dy (2) vjeçar. Afati mund të zgjatet me vendim që merret me shumicën e thjeshtë.

12.3. Në rast të zbatimit të detyrave të veta me pasoja negative për funksionimin e "Shoqërisë", Këshilli Mbikqyrës ka të drejtë të pushojë Drejtorin e Përgjithshëm para afatit. Vlerësimi i përfundimeve të Drejtorit të Përgjithshëm bëhet nga Këshilli Mbikqyrës mbi bazën e të dhënave (vlerësimeve) që jepen nga ekspertët Kontabël.

12.4. Në kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm bëjnë pjesë:

12.4.1. Organizimi i veprimtarive dhe bashkërendimi e funksionimi të "Shoqërisë".

12.4.2. Mundësia e lidhjes së kontratave të çdo lloji në emër të "Shoqërisë" me persona juridikë e fizikë në territorin e Shqipërisë ose jashtë saj, për shumat që nuk tejkalojnë 500000 lekë në vite ose kundërvlefte në dollarë të SHBA, në kursin zyrtar të ditës që kryhen veprimet.

Marrëveshjet dhe Kontratat që tejkalojnë këto shuma që të nënshkruhen nga Drejtori i Përgjithshëm duhet të kenë parapëlqimin e Këshillit Mbikqyrës ose të Asamblesë së Ortakëve sipas dispozitave të përcaktuara në statut.

- 12.4.3. Emërtimi dhe pushimi i personelit të përhershëm dhe të përkohshëm të "Shoqërisë" në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi.
- 12.4.4. Caktimi i shumave të efektshmërisë (bonot) të personelit të "Shoqërisë" (në para ose në shpërblime të tjera materiale).
- 12.4.5. Përpilimi dhe parashtrimi në Këshillin Mbikqyrës i Raporteve ekonomike në lidhje me veprimtarinë e "Shoqërisë". Rregullat e përpilimit të këtyre rraporteve vendosen nga Këshilli Mbikqyrës. Librat e "Shoqërisë" si dhe ekstraktet e llogarive ruhen në qendrën e Shoqërisë.

K R E U I V

DISPOZITA EKONOMIKE

Neni 13 Kapitali bazë - Aksionet

13.1. Për të siguruar funksionimin fillestar të "Shoqërisë" "Ortakët formojnë kapitalin bazë prej 2000000 lekë.

13.2. Kontributi i Ortakëve

Vasil Naçi	25 për qind të kapitalit bazë
Kostas Sotiri	25 për qind të kapitalit bazë
Kristo Naçi	25 për qind të kapitalit bazë
Jorgo Zoidhis	25 për qind të kapitalit bazë



13.3. Ortakët disponojnë aksione nominale të mëposhtme:

Vasil Naçi	25 aksione - vlera	50000 lekë
Kostas Sotiri	25 aksione - vlera	50000 lekë
Kristo Naçi	25 aksione - vlera	50000 lekë
Jorgo Zoidhis	25 aksione - vlera	50000 lekë

"Shoqëria" mban libra të veçantë për emërtimin e aksioneve (në përputhje me dispozitat e ligjshmërisë shqiptare) ku shënohen:

- Data e veprimit
- Emri dhe mbiemri i Ortakut
- Numrin dhe vlerën nominale të aksioneve

13.4. Në bazë të ligjeve në fuqi "Ortaku" i Huaj dhe ai Shqiptar, kontribuojnë në formimin e kapitalit bazë të "Shoqërisë" me para, pasuri, ndërtesa dhe instalime, paisje, know-how dhe të drejtat.



- 13.5. Me kalimin e kontributeve nga "Ortakët" në Kapitalin Bazë, Këshilli Mbikqyrës i "Shoqërisë" jep çdo "Ortaku" vërtetimin përkatës.
- 13.6. Nga momenti i vendosjes së kontributit në Kapitalin Bazë, "Shoqëria" fiton të drejtën e paisjes, përdorimit dhe disponimit të këtij elementi pasuror në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.

Neni 14 Llogaritë e "Shoqërisë"


- 14.1. "Shoqëria" mban llogaritë në lek (para vendase) ose në valutë.
- 14.2. Të gjitha shpenzimet e "Shoqërisë" në valutë duke përfshirë edhe fitimet që u jepen Pjesëmarrësve, sigurohen: ose nga arkëtimet në valutë nga veprimtaria e saj ose nga Blerja e Valutës së Huaj ose nga mënyra të tjera që lejon legjislacioni në fuqi.

Neni 15 Viti Ekonomik

Viti ekonomik fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor të vitit kalendarik.

Neni 16 Dhënia e llogarisë ekonomike

- 16.1. "Shoqëria" funksionon mbi bazën e dispozitave të veçanta dhe të programeve që janë miratuar nga Asambleja, Këshilli Mbikqyrës, Drejtoria të përcaktuara në Statut.
- 16.2. "Shoqëria" mban në mënyrë të pavarur librat e saj kontabile dhe situacionet. Veprimtaria ekonomike e "Shoqërisë" mbështetet në llogarinë e prodhimit, në vetëfinancimin që mbulon shpenzimet nga arkëtimet e veta, duke përfshirë edhe ato në valutë.
- 16.3. Kontrolli i përditshëm kontabël dhe statistikor bëhet mbi bazën e dispozitave që veprojnë në Shqipëri.
- 16.4. Librat kontabile mbahen në gjuhën Shqipe dhe Greke nga ekspertët kontabel (persona fizik ose juridik), që vënë në dijeni "Asamblenë" dhe "Këshillin Mbikqyrës".





- 16.5. Shumat në lekë në valutë konvertohen përkatësisht me kursin zyrtar të asaj dite që bëhet këmbimi.
- 16.6. Brenda tre (3) muajve nga mbarimi i vitit ekonomik, Drejtori i Përgjithshëm bën bilancin dhe nxjerr përfundimet e veprimtarisë (Fitimet-Humbjet) së vitit të kaluar.
- 16.7. Me qëllim që të ushtrojë të drejtën e kontrollit, çdo "Ortak" ka të drejtë të marrë informata dhe të kontrollojë çdo çështje që u takon veprimtarisë të "Shoqërisë". Çdo "Ortak" gëzon të drejtën në çdo kohë të marrë njoftime për shkresat e "Shoqërisë" dhe për të dhënat pasurore me qëllim që të ushtrojë çdo kontroll mbrojtës.

Neni 17 Kontrolli Kontabël

- 17.1. "Shoqëria" mban libra kontabile për të regjistruar të gjitha veprimet e saj në bazë të udhëzimeve të përgjithshme kontabile që veprojnë në Shqipëri.
- 17.2. Librat kontabile kontrollohen çdo vit nga ekspertet kontabël të cilët emërohen dhe veprojnë në përshtatje me ligjislacionin shqiptar në fuqi.
- 17.3. Në qoftë se dëshirojnë "Ortakët", kontrolli mund të bëhet edhe nga ekspertë të huaj dhe shpërblimi i tyre bëhet në valutë (nga llogaria e valutës të "Shoqërisë").

Neni 18 Kreditë (huatë)

"Shoqëria" ka të drejtë të marrë kredi në lekë dhe në valutë nga Bankat Shqiptare dhe të huaja në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe të procedurave të këtij "Statuti".

Neni 19 Transferimi (Jetërsimi) i aksioneve

- 19.1. Kufizimi i përgjithshëm i të drejtave të kalimit
- Asnjë ortak nuk ka të drejtë të shesi, të angazhojë ose me cilëndo mënyrë të japi ndonjë pjesë të aksioneve të tij në "Shoqëri" me përjashtim të rasteve që përmenden në këtë nen.
- "Shoqëria" nuk njih askërkënd, që ka marrë aksione të kujt do ortakut në qoftë se kjo marrje nuk është bërë sipas kushteve që parashkruhen në këtë nen.

19.2. E drejta e parësisë së zgjedhjes

19.2.1. Në qoftë se njërit nga "Ortakët" i bëhet propozim nga një i tretë për të marrë prej tij pjesërisht ose totalisht të përqindjes të pjesëmarrjes së tij në "Shoqërinë" dhe dëshiron ta pranojë këtë propozim, "Ortaku" ("Ortaku - Shitës") vë në dijeni "Ortakët" me shkresë për kushtet e propozimit ("njoftim për shitjen"). Në njoftim për shitjen përmendet përqindja e pjesëmarrjes së "Ortakut". Shitës në "Shoqërinë", që ka ndërmend të shesi, në dhe emri e adresa e të interesuarit dhe të gjithë kushtet e propozimit të tij.

Vetëm në rastin kur propozimi për blerje anulohet nga Blerësi i interesuar "Ortaku - Shitës" mund të anulohet njoftimi.

19.2.2. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e njoftimit për shitjen, një nga "Ortaku" që e mori ka të drejtë të pranojë marrjen e aksioneve dhe me kushtet e përmendura në njoftimin e shitjes.

"Ortaku - Shitës" i shet aksione "Ortakut - Blerësi" që e përdori këtë privilegj me kushtet që përmenden në njoftimin e shitjes.



19.2.3. Në qoftë se "Ortakët" pasi kanë marrë njoftimin për shitjen nuk vendosin të marrin, me privilegjin që gëzojnë (simbas nenit 20.2.2.) aksionet që shet "Ortaku - Shitës" atëherë, fundit brenda tridhjetë (30) ditëve mund të shesi përqindjen e pjesëmarrjes së tij Blerësit të interesuar me kushtet e përmendura në njoftimin për shitjen. Në qoftë se brenda 30 ditëve nuk shiten aksionet e pjesëmarrjes së "Ortakut - Shitës" atëherë zbatohen kufizimet e nenit 19.1.

Neni 20 Ndarja e fitimeve

20.1. "Shoqëria" ndan fitimet nëpër "Ortakët" proporcionalisht me pjesëmarrjen e tyre në Kapitalin Bazë të "Shoqërisë".

"Shoqëria" do të ketë fitime nga shitjet në tregun vendas dhe të jashtëm në përputhje me qëllimet e "Ortakëve" (Neni -1 i kontratës së Krijimit).

20.2. Fitimet e "Shoqërisë" do të ndahen "Ortakëve" të cilat mund të eksportohen jashtë nga "Ortaku i Huaj" në bazë të ligjeve në fuqi.



20.3.

"Ortakët" mund të riinvestojnë fitimet e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjeve në fuqi në përputhje me ligjet në fuqi.

20.4.

Me propozimin e Këshillit Mbikqyrës, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të zgjerojë veprimtaritë e "Shoqërisë" në veprimtari të tjera në territorin e Shqipërisë dhe jashtë saj.

KREU V

RASTE TË NDËRPRERJES (MBYLLJES) SË VEPRIMTARISË TË "SHOQËRISË"

Neni 21 Rastet e ndërprerjes së veprimtarisë së shoqërisë

21.1. "Ortakët" kanë të drejtë që t'i ndërpresin marrëdhëniet që rrjedhin nga Kontrata e Krijimit dhe Statuti kur vërtetohen arësytet serioze që vijnë:

21.1.1. Në qoftë se megjithë paralajmërimin e shkruar, shkelen nga një "Ortak" (Pjestar) Kushtet e Kontratës së Krijimit dhe Statutit me rrjedhojë shkeljen e veprimtarisë ekonomike të "Shoqërisë" dhe në qoftë se kjo shkelje nuk rikuperohet nga "Ortaku" tjetër, megjithë paralajmërimin e bërë me shkrim, atëherë çështja tërësisht do të diskutohet në Mbledhjen e Jashtëzakonshme të "Ortakëve".

21.2.2. Në qoftë se ndonjë veprim i organeve shtetërore, drejtëpërsëdrejti apo tërthorazi ndalon ushtrimin e të drejtave të njërit "Ortak" (Të drejtën e transferimit të fitimeve dhe ndarjes së pasurisë, ndalime lidhur me personelin) dhe si rrjedhojë bëjnë të pamundur plotësimin e kushteve që përshkruhet në kontratën e krijimit dhe të këtij Statuti.

21.1.3. Kur vërtetohen kushtet e Forcës Madhore që përshkruhen në nenin 23 të këtij Statuti.

21.2. Shkrirja e "Shoqërisë" bëhet në rastet që përmenden në këtë nen si edhe në rastet që vijnë:

- varfërimi i "Shoqërisë"

- dalje e një vendimi nga organet kompetente që ndalon veprimtarinë e "Shoqërisë", në qoftë se një funksionim i tillë vjen ndesh me ligjin dhe gjatë kohës që vepron vendimi.

- Marrja e vendimit unanin nga "Ortakët"

21.3.

Lajmërimi me shkrim për ndërprerjen e marrëdhënieve duhet të
guar me telex dhe me letër rekomande "Ortaku" tjetër në adre-
sën e tij zyrtare.

Neni 22 Procedura e shkrirjes

Pas ndërprerjes së funksionimit të "Shoqërisë" "Shoqëria "
shkrihet. Mbledhja e Përgjithshme e "Ortakëve" cakton Komisionin
në Shkrirjes. Nga çasti i emërimit të Komisionit të Shkri-
rjes të gjitha kompetencat e "Shoqërisë" i kalojnë këtij ko-
misioni sipas ligjit.

22.1.

Komisioni i Shkrirjes: Përbëhet nga tre (3) anëtarë. Çdo "Or-
taku" cakton një Anëtar dhe i treti që luan rolin e gjyqtarit
të pavarur zgjidhet nga të dy Anëtarët e lartpërmendur.

Në qoftë se brenda dyzet (40) ditëve pas dorëzimit të njofti-
mit për ndërprerjen e funksionimit të "Shoqërisë" në bazë të
procedurës së nenit 21 të këtij Statuti Mbledhja e Përgjithshme

"Ortakëve" nuk cakton Komisionin e Shkrirjes, atëherë ai
caktohet nga Kryetari i Zyrës Ndërkombëtare të Tregtis (Parisit)
pas një kërkesë prej njëri nga "Ortakët".

22.2.

"Ortaku" e Huaj mbrohet nga garancitë e ligjit "Mbi investimet
e huaja në Shqipëri".

22.3.

Anëtarët e Komisionit të Shkrirjes bëjnë punën e tyre bashkë-
risht dhe jo veçmas. Me mbulimin e të gjitha detyrimeve të
"Shoqërisë" duke përfshirë edhe ato ndaj ortakëve dhe dety-
rimeve të tjera eventuale (detyrime për rrogat) si dhe shpërblim
e Komisionit të Shkrirjes, paratë nga shkrirja ndahen
midis "Ortakëve" proporcionalisht me kontributin e tyre në
Kapitalin Bazë.

Neni 23 Forca madhore - Forca majeure

23.1.


Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi kur kanë paaftësi pjesore
apo të plotë për kryerjen e detyrimeve të tyre dhe kjo është
pasojë e rrethanave të forcave madhore që vërtetohen pas nënë-
shkrimit të kontratës së krijimit dhe ortakët nuk mund t'ju
shmangen me masa të arsyeshme.

- 23.2. Ngjarje të forcës madhore janë ngjarje që shpëtojnë kontrollin të ortakëve. Ortaku për shëmbull nuk mund të jetë shkaktar i shkatërrimeve fizike, luftrave dhe revolucioneve që sjellin pasojë ndalimin ose paaftësinë e plotë në kryerjen e detyrimeve që burojnë nga Kontrata dhe Statuti.
- 23.3. Pala e paaftë, për arsye të rrethanave të forcës madhore është e detyruar që të njoftojë me shkrim ortakun tjetër. Ortaku tjetër në qoftë se dëshiron mund të kërkojë vërtetim përkatës nga Zyra e Tregtisë e atij vendi.
- Njoftimi duhet të përmendë, kohën, natyrën, përmasat dhe vlerësimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme që pengojnë plotësimin e mirë të detyrimeve nga ana e ortakëve sikurse përcaktohen nga kontrata dhe statuti.
- 23.4. Pala që ndodhet në paaftësi të plotësojë detyrimet e saj, për arsye të forcës madhore në bazë të Kontratës dhe të Statutit duhet të bëjë çdo përpjekje që ta kapërcejë këtë paaftësi.

K R E U VI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- Neni 24 Ndryshime të favorshme në legjislacionin shqiptar
- 24.1. Në qoftë se në Republikën e Shqipërisë shpallen ligje, dekrete ose vendoset një politikë më e favorshme nga legjislacioni ekzistues gjatë kohës së vendosjes së shoqërisë atëhere ortakët kanë të drejtë (në qoftë se është e domosdoshme) t'ju drejtohen organeve përkatëse shtetërore që të zbatojnë legjislacionin më të favorshëm.
- 24.2. Në rast të kundërt, d.m.th. kur shpallen ligje e rregulla më negative, ortakët e huaj mbrohen nga garancia që përmenden në nenin 4.13. të këtij Statuti dhe të nenit 3.3. të Kontratës. Ndërkaq, ruajnë të drejtën e ndërprerjes së funksionimit të Shoqërisë pas kërkesës së tyre në bazë të nenit 21.2.2.



Neni 25 Personeli i Shoqërisë

- 25.1. Me përjashtim të anëtarëve të huaj të Këshillit Mbikqyrës dhe drejtuesve të huaj personeli i Shoqërisë kryesisht përbëhet nga shtetas Shqiptar.
- 25.2. Këshilli Mbikqyrës i Shoqërisë miraton përbërjen e personeli të Shoqërisë pas raportimit përkatës nga Drejtori i Përgjithshëm.
- 25.3. Shoqëria përsa i takon personelit zbaton legjislacionin shqiptar në fuqi.

Neni 26 Hyn në fuqi

Ky statut i përpiluar nga ortakët hyn në fuqi nga momenti që ata e kanë nënshkruar. Ortakët nënshkruajnë sipas rregullave në vendin dhe datën që përmendet.

U nënshkrua në Tiranë më 20 Gusht 1993, në 5 kopje .

O R T A K Ë T

VASIL NAÇI

KOSTAS SOTIRI

KRISTO NAÇI

JORGO ZOIDHIS

